



***Në vijim të masave të marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Shqipëri, si dhe në zbatim të Urdhërave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kanë publikuar së fundmi procedurën që duhet ndjekur për autorizimin e lëvizjeve të subjekteve private dhe punonjësve të biznesit si më poshtë:***

- Të gjithë bizneset që e kanë të domosdoshëm qarkullimin e punonjësve për në punë nga dita e premte, datë 13.03.2020, ora 06:00, deri të dielën, datë 15.03.2020, ora 00:00, duhet të akreditojnë listën e këtyre të fundit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në adresën e email-it: [policiarrugore@asp.gov.al](mailto:policiarrugore@asp.gov.al), duke i paraqitur punonjësve të Policisë një kopje të këtij email-i. Përmbajtja e email-it duhet të jetë si më poshtë:
  - Emri dhe mbiemri i punonjësit;
  - Vendi i punës ku do shkojë;
  - Orari i lëvizjes;
  - Targa e automjetit me të cilin do qarkullojë punonjësi;
  - Nuk lejohet marrja në automjet e personave të familjes apo e personave të tjerë që s'kanë lidhje me detyrën.
- Qarkullimi i automjeteve nga dita e premte, datë 13.03.2020, ora 06:00, deri të dielën, datë 15.03.2020, ora 00:00 në qytetin e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Lezhës, Elbasanit, Lushnjës, Fierit dhe Vlorës do të jetë i hapur vetëm për autoambulancat dhe automjetet që kryejnë funksione shërbimi shtetëror (personeli shëndetësor dhe social dhe shërbimet mbështetëse në strukturat e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, personeli i farmacive publike dhe jopublike, personeli që ofron shërbimet e furnizimit me ushqime, medikamente, shërbimet e kateringut, shërbimet postare, zjarrfikëse, funerale, energjisë, ujësjellës kanalizime, shërbimet private të ruajtjes së sigurisë së objekteve, shërbimet aeroportuale dhe personeli i linjave ajrore), duke dërguar pranë adresës së email: [policiarrugore@asp.gov.al](mailto:policiarrugore@asp.gov.al), listën e personave të autorizuar dhe duke i paraqitur punonjësve të Policisë një kopje të këtij email-i.



***Following on the measures taken to prevent the spread of COVID-19 in Albania, as well as for the implementation of the Orders of the Ministry of Health and Social Protection, the State Police and the General Directorate of Taxation have recently published the procedure to be followed for authorizing the movements of private entities and business employees as follows:***

- All businesses must accredit the list of the employees that shall use vehicles only for business purposes from Friday, March 13, 2020, 06:00 AM, until Sunday, March 15, 2020, 00:00, to the General Directorate of State Police at the following email address: [policiarrugore@asp.gov.al](mailto:policiarrugore@asp.gov.al) and show to the police officials a copy of this email. The content of the email sent to the State Police should be as follows:
  - Name and surname of the employee;
  - Destination of workplace/business premises;
  - Hours of movement;
  - Vehicle license plate of the employee;
  - It is prohibited to take in the vehicle family members or other persons unrelated with the company/business.
- Vehicle circulation from Friday, March 13, 2020, 06:00 AM, until Sunday, March 15, 2020, 00:00, in the cities of Tirana, Durrës, Shkodra, Lezha, Elbasan, Lushnjë, Fier and Vlora shall only be permitted to ambulances and vehicles performing public service functions (health and social staff and support services in public health care facilities), and non-public, public and private pharmacy personnel, personnel providing catering services, medications, food supply, postal services, fire services, funerals, energy, water supply and sewerage, private facility security services, airport services and personnel of Airlines), by sending an email to the address: [policiarrugore@asp.gov.al](mailto:policiarrugore@asp.gov.al), with the list of authorized employees, and showing a copy of this email to the Police Officials.